

# KREMTIMI I DITËS SË PAVARËSISË SË KOSOVËS

Kontribuar nga Administrator  
Freitag, 17 Februar 2012  
Azhornuar së fundi Freitag, 17 Februar 2012

Çdo popull në historinë e vet ka momente të kthesave të mëdha, kur vendoset për fatin se do të hyjë apo nuk do të hyjë ai popull në histori, me fjalë tjera, kur vendoset se do të jetojë ai popull me dinjtet e krenari apo do të jetë i detyruar të eliminohet nga skena e jetës dhe historisë. Me 17 shkurt 2008, Kosova hyri në histori dhe me meritë, krenari e dinjtet.

Këto ditë anembanë Kosovës po përjetohej momentet e shpalljes së Pavarësisë.

Njëqind vjet sakrifica, vetëmohime e luftë të vazhdueshme për liri, megjithatë nuk u mposht shpirti i shqiptarit të Kosovës. Njëqind vjet rezistencë të pathyeshme përballë pushtuesit që në gjenet e veta kultivoi urrejtjen e militantizmin antishqiptar, megjithatë shqiptarët nuk u përkulën, nuk u gjunjëzuan. Periudhë e gjatë në të cilën shqiptarët përjetuan male të këqijash dhe u persekutuan, u rrahën, u keqtrajtuat dhe u plaçkitën, u torturuan dhe u dërgjen me vite të tëra nëpër burgje, qindra mijëra u pushuan nga puna duke lënë familjet e tyre pa kafshatën e bukës, qindra mijëra të tjerë u deportuan dhe u shpërngulën me dhunë nëpër te gjithë globin, iu dogjën shtëpitë dhe iu përvëluan fëmijët, u vranë dhe u masakruan, vetëm në luftën e fundit u vranë rreth 20 mijë shqiptarë dhe u hapen mbi 600 varre masive, megjithatë ky popull nuk u dorëzua dhe gjithmonë doli fizikisht edhe më i fuqishëm, shpirtërisht edhe më i pasur e moralisht edhe më i qëndrueshëm, por nuk u dorëzua dhe nuk e humbi substancën e identitetit kombëtar. Zoti Madh deshi që ky komb të kalojë nëpër zjarrin e madh të sakrificave për të kalitur shpirtin dhe vullnetin e tij kolektiv. Individët bëhen të lavdishëm e të pavdekshëm vetëm nëpërmjet sakrificave e vetëmohimeve, e popujt të mëdhenj e të fuqishëm vetëm nëse janë të gatshëm për sakrifica për të mirën e kombit, për të mirën e përgjithshme.

Mirëpo, sot nuk është koha të vajojmë për të kaluarën tonë të hidhur, por të festojmë të sotmen tonë të pavarësisë dhe të shikojmë përpara, sepse e ardhmja jonë do të jetë më e mirë se e kularja jonë. Sot, pra kemi festë, kremtojmë njëqindvjetorin e pritjes. Një qind vjet në pritje për këtë ditë të madhe. Le të gëzohemi të gjithë të mëdhenj dhe të vegjël, burra e gra, të gjithë shqiptarët ku do qofshin ata. Le të gëzohemi të gjithë sepse me pavarësinë e Kosovës të gjithë shqiptarët fitojnë, sepse tashmë shqiptarët po bëhen faktor në Evropë. Evropa po ndërron fizionominë e vet duke ia kthyer këtë të drejtë natyrore Kosovës të cilën ia kishte marrë qindra vjet më parë. Evropa, më në fund po e ndërron edhe hartën e vet më shtetin më të ri në kontinentin vet.

Ne nga ky vend i nderuar dhe në këtë ditë të madhe i ftojme fqinjët tanë, njerëzit e vullnetit të mirë, që të mblidhemi rreth të vërtetës dhe drejtësisë për hir të paqes, për të ardhmen më të mirë të fëmijëve tanë, për hir të ndihmës së Zotit për ta rikthyer besimin mes njerëzve. Që të mos i lutemi askujt tjetër përveç Zotit Një të Vetëm, që të mos i bëjmë asnjë shok Atij dhe që të respektojmë njëri tjetrin. Kjo është më mirë për ne nëse ia duam të mirën secilit njeri. Ky është shpëtim nga e keqja. Për këtë na obligon fati i përbashkët dhe shpresa e përbashkët për të ardhmen më të mirë.

Të nderuar vëllezër, atdheu është vendi ku kemi lindur dhe ku jemi rritur. Për të na lidhin ndjenjat, malli dhe emocionet. Ai është e drejta jonë. Atdheu nuk është çështje e dorës së dytë në jetë, prandaj, dhe kujdesi për të dhe fati i tij nuk mund të lihet në dorë të huaj. Atdheu është përgjegjësia ime dhe e jotja, çështje e rëndësishme në jetën tonë të përbashkët dhe kujdesi ynë prej të cilit nuk mund të heqim dorë duke ia lënë në dorë dikujt tjetër. Për Kosovën 17 shkurti i 2008-ës nuk ka alternativë. Ajo ditë është shenjë e luftës sonë shekullore kundër pushtuesit të pamëshirshëm dhe ajo është e vetmja festë që s'ka alternativë. 17 shkurti tregon se shqiptarët në mënyrë të pakthyeshme i dhanë lamtumirën robërisë. Pas 17 shkurtit definitivisht edhe ajri mbi territorin Kosovës do të jetë i pastër dhe shqiptarët tash tutje do të marrin frymë në liri. Edhe fushat e punuara e arat e mbjella ushqim i pastër për çdo të ri. Edhe lumeje të kulluar ujë për të pi, edhe malet e lira prej të cilave mund të shikohet bota në largësi.

Tani atdheut i duhen rrugë të mira që të mund të ecet nëpër to, shkolla të pajisura që të mund të mësohet, spitale të aftësuara e të specializuara që të mund të shërohem, xhami dhe kisha të shndritshme që të mund të madhërohet Zoti, djem të guximshëm që të mund ta mbrojnë prej të këqijave dhe pasardhës të shëndetshëm që të mund të ëndërrojnë për të ardhmen.

Atdheut i duhen patriot të besueshëm të cilët nuk do të hedhin baltë mbi të nëpër botë, as nuk do të tallen më dhimbjen e tij, as nuk do t'i nënçmojnë dëshmorët e tij, as t'i akuzojnë heronjtë e tij.

Atdheu është i shtrenjtë...

Të kesh atdheun tënd, do të thotë të kesh shtëpinë tënde, e të mos kesh atdheun tënd, do të thotë të mos kesh shtëpinë tënde. I lirë është ai që i bëhet rob vetëm Zotit, e rob i vërtetë është ai që i bëhet rob njeriut. I lirë është ai që ka vatanin e vet, e rob është ai që s'ka vatan.

“Dashuria ndaj atdheut është pjesë e besimit” tha Profeti i nderuar Muahmmedi (a.s.).

Të duash emrin tënd, gjuhën tënde, kulturën dhe vendin tënd nuk është gjynah. Të respektosh emrin e huaj (tjetrit), gjuhën e huaj, kulturën dhe fenë e tjetrit nuk është gjynah. Në të vërtetë, është farz të duash tënden e të respektosh të huajën.

Në këtë ditë të madhe historike, nuk duhet t'i harrojmë ata të cilët u flijuan dhe e dhanë jetën për lirinë e atdheut dhe për këtë ditë të madhe të pavarësisë. Ata janë dëshmorët, të cilët derdhen gjakun e shenjtë për tokën Kosovës. Të cilët dhanë atë më të shtrenjtën për lirinë tonë. Ata të cilët u dogjën vetë si qiri për t' na bërë drite neve, për t'i bërë dritë Kosovës.

Këta njerëz, nga e gjithë Kosova dhe trojet tjera, luftuan dhe me veprën e tyre u bënë dëshmorë, heronj të vendit, të cilët do të përkujtohen sa të jetë jeta, e përkujtimi i tyre më i mirë është shpërblimi i Zotit në ahiret për shpirtat e sakrifikuar në dynja dhe për atë që realizuan vendosjen e atdheut të dyfishtë: atdheut hapësinor dhe atij shpirtëror.

Ata që sakrifikuuan gjumin e tyre në mënyrë që një popull i tërë, burra e gra, të mëdhenj e të vegjël, të dobët e të fuqishëm, ta shijojnë të qetë gjumin, ata që e konsumuan veten me qëllim që populli të jetojë pa frikë dhe që e bënë mburojë ekzistencën e vet për sigurinë e të tjerëve. Ja, këta janë të denjë për t'u kujtuar sot me respekt.

Këta janë ata të cilët luftuan për t'i mbrojtur vlerat universale njerëzore. Të luftosh për mbrojtjen e vlerave themelore, sikurse janë: mbrojtja e jetës, e nderit dhe e moralit, dinjitetit e krenarisë, besimit e atdheut dhe çdo gjëje që është fisnike, e drejtë dhe madhështore, d.m.th. të bësh rezistencë aktive kundër atij apo atyre që mbjellin urrejtje, shkaktojnë krime e dhunë dhe të japësh jetën tënde në mbrojtje të atyre vlerave, do të thotë të jesh shehid, dëshmitar, dëshmor edhe i kësaj bote edhe i botës tjetër (shehidu'd-dunja ve'l-ahireh) – dëshmor i dynjasë dhe i ahiretit. Dëshmor që dëshmon për kalueshmërinë e dynjasë dhe përjetshmërinë e ahiretit; dëshmon për zhbërjen e trupit dhe pavdekshmërinë e shpirtit.

Për shehidët e këtillë All-llahu (xh. sh.) në Kur'an thotë:

“Kurrresi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e All-llahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. Ata janë të gëzuar me atë që u dha All-llahu nga të mirat e Tij, dhe atyre që kanë mbetur ende pa iu bashkuar radhëve të tyre, u marrin myzhdë se për ta nuk ka as frikë as shqetësim. Ata janë të gëzuar me begati e dhurata që ua dha All-llahu, e s'ka dyshim se All-llahu nuk ua humb shpërblimin besimtarëve.” (Ali Imran, 169 – 171)

O Zoti i Mëshirshëm:

të sëmurëve jepu shëndet,

të varfërve furnizim,

të burgosurve liri,

të përndjekurve kthim në vatrën e tyre,

mbrojtësve tanë ndihmë,

dëshmorëve shpërblimin më të mirë,

jetimëve përkujdesje e ngrohtësi,

atdheut tanë paqe e liri.

Fuqizoi të parët tanë me urtësi e trimëri

Fisnikëroi të gjithë njerëzit me dashuri dhe mëshirë!

Pastroi zemrat e njerëzve nga urrejtja dhe e keqja!

Dhuroja gjithë botës udhëzimin dhe mëshirën Tënde

Pash mirësinë Tënde të pamë dhe Pash mëshirën Tënde në këtë ditë të madhe! (Amin

P. S. Fjalim i mbajtur në Xhaminë e Shqiptarëve në Wels të Austrisë me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.